



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	37646-1/2025
Nr. i fq. / Br. st	-
Data: / Datum	31.07.2025
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me grupe të ndryshme të grave

Korrik, 2025

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për përgatitjen e Buxhetit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2026, i mbajtur me grupe të ndryshme të grave.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Ora: 14:00

Data: 15.07.2025

Të pranishëm nga Komuna ishin Melihate Basholli Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës, Isuf Jashari, Drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, asamblistet e Kuvendit të Komunës, Zojë Hajrizi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia dhe Kimete Mulaku, zyrtare në drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Thesar.

Melihate Basholli Latifi, kryesuese, hapi takimin dhe tha se në këtë takim do të mblidhen kërkesat e grave pjesëmarrëse për përfshirje në buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2026.

Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, paraqiti para grave pjesëmarrëse në takim buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2026 dhe projektet e parapara.

Grave të pranishme në këtë dëgjim ju është shpërndarë material informues për buxhetin e vitit 2026.

Më pas, fjalën e morën gratë pjesëmarrëse, të cilat paraqitën kërkesat e tyre.

Nerxhivane Krasniqi, banore e fshatit Zhilivodë, kërkoi përkrahje për biznesin familjar si dhe themelimin e një pike grumbullimi për të gjitha gratë që merren me veprimtarinë e turshive, në mënyrë që gratë e zonës të punojnë së bashku. Ajo theksoi se mungesa e transportit mbetet problemi kryesor për fshatrat Zhilivodë, Bivolak dhe Stroc. Kërkoi gjithashtu donacione për një shoqatë të grave që aktualisht punojnë në mënyrë individuale.

Vildane Mulaku, kryetare e Shoqatës “Martirët e Lirisë”, kërkoi ndarjen e buxhetit për veteranët dhe rregullimin e varrezave të Studimes.

Fikrije Ferizi, kryetare e OJQ “ATO”, kërkoi renovimin e objektit ku zhvillohen aktivitete, organizimin e trajnimeve vetëdijësuese për gra, ofrimin e mbështetjes për gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit, si dhe hapjen e çerdheve dhe qendrave ditore për fëmijë. Ajo theksoi gjithashtu nevojën për përkrahje në punësim dhe kujdes të veçantë për të moshuarit e vetmuar.

Hasime Gërxhaliu, banore e fshatit Studime, parashtrroi kërkesë për asfaltimin e rrugës 2 Maji dhe rrugës “Fatmir Gërxhaliu”.

Albulena Gërxhaliu, banore e fshatit Sfaraqak, kërkoi përfundimin e rrugës për në fshatin Sfaraqak, si dhe intervenim për largimin e qenve endacak.

Suzana Ajvazi, banore e fshatit Maxhunaj, kërkoi shtrirjen e rrjetit të ujësjetllësit në rrugën “Safet dhe Adem Bekteshi” në fshatin Maxhunaj.

Ganimete Mehulli, banore e fshatit Akrashticë, propozoi që të rregullohet edhe në urën e fshatit Akrashticë, pasi po asfaltohet rruga.

Shqipe Shaqiri, banore e fshatit Brusnik, parashtoi kërkesë për ndriçim publik në këtë fshat, si dhe emërtimin e lagjes ku jeton.

Habibe Jashari, banore e fshatit Oshlan, kërkoi mbështetje për biznes individual nga Komuna.

Në këtë takim kanë marrë pjesë gjithsej 16 gra.

Procesmbajtëse:

Mirjeta Duraku



